



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2022:080295

Datë: 09.02.2024

Numri i dokumentit: 05431729

P.nr.200/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEGA NË ISTOG, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Petrit Nrecaj, me procesmbajtësen Hale Ahmetaj, në çështjen penale kundër të pandehurve personit juridik “P-D” sh.p.k. dhe të pandehurit D.P, secili veç e veç të akuzuar për shkak të veprës penale shmangia nga tatimi nga neni 307 par. 2 lidhur me par. 1 lidhur me nenin 77 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (tutje KPRK), të akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.596/22 të datës 13.07.2022, pas mbajtjes së seancës publike të shqyrtimit fillestar më datë **10.01.2024**, në prezencë të Prokurorit të Shtetit Dorjan Juniku, Lumturije Xhaka përfaqësuese e palës së dëmtuar Administrata Tatimore e Kosovës, mbrojtësit të pandehurit personit juridik “P-D” sh.p.k. av.Daut Demiraj dhe të pandehurit D.P se bashku me mbrojtësin e tij av.Valon Demiraj, të njëjtën ditë mori dhe shpalli, ndërsa me datë 09.02.2024, përpiloi, këtë:

A K T G J Y K I M

Të pandehurit:

- 1. Personi juridik “P-D” sh.p.k**, me përfaqësues të autorizuar sipas ligjit dhe statusit Servet Pepe, me numër unik identifikues ..., me numër fiskal..., me adresë në rr. “P.” në fshatin G., Komuna I.
- 2. D.P**, nga i ati S. dhe e ëma F. e gjinisë A., i lindur me datë ... në Istog, me vendbanim në fshatin G. rr. “B.K.” nr. 34 Komuna I., i martuar, baba i tre fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i punësuar si person përgjegjës i personit juridik “P-D” sh.p.k, pensionist, i gjendjes se mesme ekonomike, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet në liri.

JANË FAJTOR

Sepse:

I pandehuri personi juridik “P-D” sh.p.k:

1. Gjatë periudhës së vitit 01.01.2018 e gjer me datë 31.12.2020, i pandehuri “P-D” SH.P.K me numër fiskal .. dhe numër unik identifikues .. në fshatin G., Komuna I., me përfaqësues të autorizuar sipas ligjit dhe statusit S.P, me qëllim që t’i shmanget pagesës së tatimit dhe kontributeve tjera në vlerën që tejkalon shumë prej pesëmbëdhjetë (15.000) €, pagesë kjo që kërkohet me me Ligjin 03/L-222 për Administratën Tatimore, ku nuk përfshinë të dhënat lidhur me të ardhurat e tij në atë mënyrë që pas një informacioni nga pala e tretë që subjekti në fjalë “P-D” SH.P.K me numër fiskal 600723036 dhe numër unik identifikues ...se i pandehuri nuk ka mbajtur libra të regjistrimit, nuk ka prezantuar faturat e shitjes, nuk ka bërë pagesa përmes banke ashtu siç kërkohet me ligj, dhe gjatë një kontrolli kanë gjetur se i njëjti është duke shmangur tatimin ku sipas ekspertizës financiare ka shmangur tatimin me vlerë të shtuar dhe me këtë 35,061.31 €, i shkakton dëme buxhetit të Kosovës.
 - me çka ka kryer veprën penale shmangia nga tatimi nga neni 307 par.2 lidhur me par. 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

I pandehuri D.P:

2. Gjatë periudhës se vitit 2019-2020 në fshatin G, Komuna I., me qëllim që t’i shmanget pagesës së tatimit dhe kontributeve të tjera në vlerën që tejkalon shumë prej pesëmbëdhjetë (15.000)€, pagesë kjo që kërkohet me Ligjin 03/L-222 për Administratën Tatimore, ku nuk përfshinë të dhënat lidhur me të ardhurat e tij, në mënyrë që, gjersa i pandehuri si person përgjegjës i personit juridik “PEPE-D” SH.P.K me numër fiskal 600723036 dhe numër unik identifikues ..., gjatë kontrollit nga zyrtaret e ATK-së mbi bazën e informacionit nga pala e tretë, ka gjetur se i pandehuri nuk ka mbajtur libra të regjistrimit, nuk ka prezantuar faturat e shitjes dhe nuk ka bërë pagesa përmes banke ashtu siç kërkohet me ligj dhe kështu sipas ekspertizës financiare ka shmangur tatimin me vlerë të shtuar dhe me këtë i shkakton dëme buxhetit të Kosovës në vlerë prej 35,061.31 €.
 - me çka ka kryer veprën penale **shmangia nga tatimi nga neni 307 par.2 lidhur me par. 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së.**

Gjykata duke u bazuar në nenet e lartcekura të veprave penale dhe dispozitat e nenit 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 43, 44, 69 të KPRK-së dhe nenin 242, 364 dhe 369 të Kodit Nr.08/L-032 të Procedurës Penale (tutje KPP-së), të pandehurit i:

GJYKON

- I.** Ashtu që, të pandehurit **personit juridik “P-D” sh.p.k.**, i shqiptohet dënimi me gjobë në shumën prej pesëqind (500) euro, të cilën shumë është i obliguar ta paguajë në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- Nëse i pandehuri **personit juridik “P-D” sh.p.k.** nuk e paguan dënimin me gjobë, brenda afatit kohor të përcaktuar me lartë, atëherë dënimi më gjobë do të ekzekutohet me detyrim përmes përmbarimit.
- II.** Ashtu që, të pandehurit **D.P.**, i shqiptohet dënimi me gjobë në shumën prej dyqind e pesëdhjetë (250) euro dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve, i cili dënim me pëlqimin e të pandehurit konform nenit 44 të KPRK-së, i zëvendësohet më dënim me gjobë në shumën prej dyqind e pesëdhjetë (250) euro, të cilat dënime me gjobë i pandehuri është i obliguar t'i paguajë në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- Nëse i pandehuri **D.P.**, nuk mundet apo nuk dëshiron t'i paguaj dënimet me gjobë në afatin kohor të përcaktuar me lartë, atëherë dënimet më gjobë do të zëvendësohet më dënim me burgim, konform nenit 43 par.3 të KPRK-së, ku për çdo njëzet (20) euro të gjobës, do ti llogaritet me një (1) ditë burgim, *përkatësisht 25 ditë burgim.*
- III.** REFUZOHET propozimi i prokurorisë që ndaj të pandehurve të shqiptohet dënimi plotësues, ndalimi i ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.
- IV.** **OBLIGOHEN** të pandehurit që bashkarisht në emër të shpenzimeve të procedurës penale, të paguajnë shpenzimet për ekspertizën financiare në shumë prej **dyqind e pesëdhjetë (250) euro**, paushallin gjyqësor në shumë prej **njëzet (20) euro**, ndërsa në emër të taksës për programin për kompensimin e viktimave të krimit secili veç e veç të paguajnë shumën prej **njëzetë (20) euro**, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- V.** **Pala e dëmtuar:** Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, nuk kishte kërkesa pasurore juridike.

A r s y e t i m

Rrjedha e procedurës penale

Në këtë gjykatë, Prokuroria Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.596/2022 të datës 13.07.2022, kundër të pandehurve personit juridik “P-D” sh.p.k. dhe të pandehurit D.P, secili veç e veç të akuzuar për shkak të veprës penale shmangia nga tatimi nga neni 307 par. 2 lidhur me par. 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestar me datë 10.01.2024, në të cilën seancë kanë prezantuar Prokurori i Shtetit Dorjan Juniku, Lumturije Xhaka përfaqësuesja e palës së dëmtuar ATK-së, mbrojtësi i personit juridik “P-D” sh.p.k av.Daut Demiraj i caktuar sipas autorizimit dhe i pandehuri D.P se bashku me mbrojtësin e tij av. Valon Demiraj i caktuar sipas autorizimit, ku pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit, gjykata pasi që është bindur se te pandehurit e kanë kuptuar akuzën, dhe pas njoftimit me benifitet dhe pasojat e pranimit të fajësisë, iu ka mundësuar të pandehurve të deklarohen për pranimin e fajësisë apo të deklarohen të pafajshëm.

Mbrojtësi i personit juridik “P-D” sh.p.k., av. Daut Demiraj, ka deklaruar: se e pranon fajësinë për veprën penale për te cilën akuzohet personi juridik, duke shtuar se sipas vërtetimit tatimor te datës 27.12.2023 dhe marrëveshjes për pagesën e borxheve tatimore me këste te dorëzuara ne këtë seancë ne gjykatë, këtu i pandehuri personi juridik ka bere pagesën e demit te shkaktuar me vepër penale siç përshkruhet ne aktakuzë.

I Pandehuri D.P, pas konsultimit me mbrojtësin e tij, ka deklaruar: se e pranon fajësinë për veprën penale për te cilën akuzohet, është i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë, pranimin e fajësisë e bënë në mënyrë vullnetare dhe pa presion nga askush, duke shtuar se jam penduar për këto veprime dhe sipas vërtetimit tatimor te datës 27.12.2023 dhe marrëveshjes për pagesën e borxheve tatimore me këste te dorëzuara ne këtë seancë ne gjykatë këtu i pandehuri personi juridik ka bere pagesën e demit te shkaktuar me vepër penale siç përshkruhet ne aktakuzë.

Prokurori i Shtetit, lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve, ka deklaruar: se pajtohem me pranimin e fajësisë te deklaruar nga ana e te pandehurve për veprat penale për te cilat akuzohen. Sa i përket propozimit qe ndaj këtu te pandehurit te shqiptohet dënimi plotësues sipas nenit 59 par.2, nenpar.2.4 e lidhur me nenin 63 te KPRK-së, heqim dore nga propozimi për shqiptimin e këtij dënimi plotësues, për faktin se si i tillë tani është i pa nevojshëm me qene se këtu i pandehuri si prove materiale deponoj dëshminë siç është marrëveshja për pagim te borxhit me këste i cili ne rastin konkret ka paguar borxhin ne tërësi ndaj te dëmtuarës Administratës Tatimor te Kosovës.

Përfaqësuesja e palës se dëmtuar Administrata Tatimore e Kosovës, Lumturije Xhaka, lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve ka deklaruar: se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurve, gjithashtu kompensimi i dëmit është bere nga i pandehuri ne tërësi i dal nga kontrolla e ATK-së e qe përfshihet në këtë aktakuzë, gjithashtu deklarojmë se nuk kemi kërkesës pasurore juridike.

Mbrojtësi i të pandehurit personit juridik “P-D” sh.p.k, av.Daut Demiraj, lidhur me pranimin e fajësisë nga i mbrojturi i tij, ka deklaruar: i propozoj qe pranimi i fajësisë dhe përmbushja e demit te shkaktuar te merr si rrethanë lehtësues me rastin e shqiptimit te dënimit te njëjtiti ti shqiptoj një dënim me te lehte.

Mbrojtësi i te pandehurit D.P, av. Valon Demiraj, lidhur me pranimin e fajësisë nga i mbrojturi i tij ka deklaruar: se mbështes pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit, ky pranim fajësisë vjen si rezultat i konsultimit me te njëjtën, i njëjti është i njoftuar me pasojat dhe benifitet

e pranimit të fajësisë, i propozoj gjykatës që me rastin e vendosje lidhur me vendimin mbi dënimin, ndaj të mbrojturit tim t'i zbatohet rrethanat lehtësuese, po ashtu në rast se gjykata vendos që të pandehurit të shqiptohet dënimin me burgim, japim pëlqimin që i njëjti dënim të konvertohet në të holla.

Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjykata në rastin konkret lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve, pas marrjes së mendimeve të lartcekura si dhe se pas vërtetimit se janë përmbushur kërkesat nga neni 242 par. 1, par. 2 nën par. 2.1, 2.2 dhe 2.3, dhe par.3 të KPP-së, përkatësisht pas vlerësimit se të pandehurit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se ky pranim është bërë në baza vullnetare dhe se mbështetet në faktet dhe provat që përmban aktakuza, po ashtu pas vërtetimit se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike të paraparë me nenin 242 par. 2, nën par. 2.4 të KPP-së, gjykata ka pranuar pranimin e fajësisë nga të pandehurit për veprat penale të lartcekura për të cilat janë akuzuar.

Vendimi për shpalljen fajtor

Gjykata nga të lartcekurat ka vendosur që të pandehurit t'i shpall fajtor për veprat penale për të cilat janë akuzuar dhe i ka gjykuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që gjeti sete njëjtit janë penalisht përgjegjës dhe se nuk ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale të të pandehurve, po ashtu në veprimet e tyre manifestohen të gjitha elementet subjektive dhe objektive të veprave penale të lartcekura si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Pas pranimit të fajësisë nga të pandehurit dhe konstatimit nga gjykata të përmbushjes së kushteve në referim të nenit 242 par. 1, 2 dhe 3 të KPP-së, gjykata ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Rrethanat që janë marre për bazë me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e marrjes së vendimit sa i përket sanksionit penal, përkatësisht me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, vlerësoi të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese, të cilat konform nenit 69 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, ashtu që për të pandehurin **personin juridik "P-D" sh.p.k.**, si **rrethana lehtësuese** ka gjetur se ka pranuar fajësinë dhe të dëmtuarës i'a ka paguar dëmin e shkaktuar me vepër penale; ndërsa **rrethana rënduese** nuk ka gjetur; për të pandehurin **D.P.**, si **rrethana lehtësuese** ka gjetur se ka pranuar fajësinë dhe rrethanat personale se është penduar për veprën penale, nuk ka qene i dënuar me parë dhe moshën e të pandehurit; ndërsa **rrethana rënduese** nuk ka gjetur. Andaj, Gjykata në rastin konkret nga rrethanat e lartcekura, ka vlerësuar se dënimet e shqiptuar ndaj të pandehurve, të precizuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, janë në proporcion me peshën e veprave penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesve, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimet e tilla do të ndikojnë në risocializimin dhe riedukimin e këtu të pandehurve, të cilët do ta kuptojnë rëndësinë e veprës penale të cilën e kanë kryer dhe në këtë mënyrë të njëjtit do të reflektoj që në të ardhmen mos të shkaktoj veprime të ndaluara-përkatësisht mos të kryej vepër penale, si dhe do të ndikojnë tek personat tjerë të mos kryejnë vepra

penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit konform nenit 38 të KPRK-së.

Gjykata në këtë çështje penale vendimin për zëvendësimin e dënimit me burg më dënim me gjobë, për të pandehurin D.P, e ka marrë konform nenit 44 të KPRK-së, meqenëse edhe i pandehuri përmes mbrojtësit të tij ka dhënë pëlqim se ne rast që gjykata i shqipton dënim me burgim, i njëjti dënim të zëvendësohet në dënim me gjobë.

Vendimi për refuzimin e dënimit plotësues

Gjykata vendimin në pikën III, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, e mori pasi që, prokurori i shteti siç theksohet edhe më lartë, ka deklaruar se heq dorë nga propozimi për shqiptimin e dënimit plotësues të propozuar në aktakuzë.

Shpenzimet e procedurës

Gjykata duke vendosur lidhur me shpenzimet e procedurës, në kuptim të nenit 452 par. 1 dhe nenit 449 par. 2 të KPP-së, i ngarkoi të akuzuarit me shpenzimet e procedurës të precizuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e po ashtu konform Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, i obligoi të paguajnë taksën për programin për kompensimin e viktimave të krimit.

Udhëzimi i palës së dëmtuar për kërkesat pasurore-juridike

Gjykata nuk e udhëzoi palën e dëmtuar në kontest civil për realizimin e kërkesave pasurore juridike, ngase siç theksohet më lartë, e njëjta përmes përfaqësues se autorizuar, ka deklaruar se meqenëse nga të pandehurit është paguar dëmi i shkaktuar me vepër penale, nuk ka kërkesë pasurore juridike.

Gjykata duke u bazuar në arsyet e lartshënuara e në bazë të neneve 242, 364 dhe 369 të KPP-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEGA NË ISTOG Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

**Procesmbajtësja
Hale Ahmetaj**

**Gj y q t a r i
Petrit Nrecaj**

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit të Kosovë në Prishtinë, *në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.*